

## **PROFILI SHOQËROR, PROFILI I PËRGJITHSHËM**

### **PJESA I**

#### **MARTIN CAMAJ - *Rrungaja në mars (fragment)***

... Vajza e ndryni zemrën e vet. Jetoj tue këqyrë mbi krena të njerëzve, tue mos u mundue të dijë, me vjet, kush lindte, martohej apo vdiste. I bani në asgja fjalët e katundit se ajo qenka grueja ma kryenalta e mbarë vendit. Fjalët e botës për dashuni e gëzime jete ishin frymë, dokrra të thata. E hijshme deri vonë, për ata mashkuj që deshën ta afrojnë, ajo mbeti diçka si pranverë e përhershme buzë lumit, prore tue prapue ndjesi e shllime të hueja, me dhimbën e pjekun në zemër – qiell i patrazuem. Megjithatë Jerës çdo vjetë, në mars, i përhidhej fryma në fyt; ndoshta i binte mall për burrë. Po për të mos mbetë e pengueme, lidhë për laku në një ndjesi, thellohej heshtazi në kundrimin e rrjedhës së lumit që dirgjej, tue gjarpnue edhe në tru të saj, grykave mbi katund dhe para syve të grues bante bërryl e përqafonte ara e livadhe.

Kundro sot, kundro nesër, së mbrami iu dha me shikue nga dera e shtëpisë së vet edhe kreshtën e malit që ndante katundin buzë lumit me Përtejçafën. Me një shikim andej dhe u kujtue se i kishte kalue gati krejt acarimi kundër njerëzve për shkak të fatkeqësisë së dikurshme. Nisi me shijue moti në mot edhe ndërrimet e stinëve, hijet e dritat e ndryshme myseve, çdo fazë të rritjes së pemëve gjithnduersh, të mollës e të ftonit të fortë. Këqyr, këqyr! – thoshte ajo,- deri fiku rritet këtu ndër ne, ndonëse rripa e murrilanit lan gurin, kaq ashtë ajo e acartë!

Pash për pash, prej vjeti në vjetë, për së gjani e për së gjati u zmadhue edhe rruga buzë lumit që barte natë e ditë shtegtarë të panjehun. Nga Përtejçafa uleshin ma shumë njerëz se sa ngjiteshin; aq ma pak ndaleshin pranë krojeve me pushue e pi ujë. As synin nuk e çonin nalt me shikue mbi udhë tandat e hardhive plot vile rrushi të zi, as me qenë ky larushk e kurrëgjja tjetër, tue e krahasue me atë të vneshtnave e pjergullave të tyne andej qafës! Jera mrekkullohej: si paska qenë e mundun, mote ma parë, me u ndalë aty një djalë nga Përtejçafa, Daku, ma i pashmi e ma i mendshmi i të gjithëve, i cili me një djegë të përflakët kishte dashë me marrë gjithçka me vete! Një, vetëm një prej fisit të tij të ishte ndalë në kambë sa për t'i

### *Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

thanë në të folmen e vrazhdë të Përtejçafës: sa e shemtuet kënge! Do të ishte gëzue Jera. Por asnjë për be nuk qëndroi, as Jerës nuk iu dha rasti t'i thotë një njeriu të vetëm nga Përtejçafa se po e këputka malli me folë me njenin sish.

U muer vesh se, jo vetëm Jera që ishte e dashnueme, në përgjithësi malësorët e andej kreshtave, por asnjë banor i katundit buzë lumit, nuk kishte ma të voglën marrëdhanie me përtejçafasit. Ata dhe këta të kësaj ane i lidhte vetëm një vizë e drejtë, rruga pa asnjë vend pushimi ose tregtizë të vogël.

.....  
Një vjet para se të vdiste, Jera ndeshi në rrugë një plak ma se tetëdhjetë vjeç. Ky kishte shikimin e Dakut, andaj e pyeti:

“Si të quejnë, or burrë?”

“Loshi! –u përgjigj ai. –Çka po të duhet emri im?”

Ajo nuk e thirri në shtëpi pse, ndonëse me një sëmundje të pashërueshme në lukth, iu duk paurti t'ia lëndojë plakut e vetes varrën e vjetër.

Pas takimit me Loshin, që s'ia merrte mendja se kush ishte ajo, sytë iu turbulluan edhe ma tepër dhe as kur flente nuk i mbylleshin fare. Rrinin si në pritje të diçkasë, të rreshkun e të thatë, pa dashuni ose dhimbje as për vete, jo! Sepse Jera kishte vdekë dalngadalë shumë mote ma parë.

*Matura Shtetërore 2007, Teste*

---

*Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

- 1.** Në këtë novelë, Camaj vjen si përfaqësues i: **1 pikë**  
A) ekspresionizmit.  
B) natyralizmit.  
C) hermetizmit.  
D) surrelizmit.
- 2.** Çfarë simbolizon titulli i tregimit? **1 pikë**  
A) Jetën e ndërprerë në mes.  
B) Kapërcimin e vetmisë.  
C) Rilindjen e jetës.  
D) Sfidën ndaj vdekjes.
- 3.** Ç'ka dashur të përcjellë autori përmes kësaj novele? **1 pikë**  
A) Njeriu nuk ngrihet dot kundër fatit.  
B) Koha shëron çdo lloj vuajtjeje dhe lëndimi.  
C) Vetmia sjell pasoja tragjike për njerëzit.  
D) Njeriu duhet t'u besojë rastësive në jetë.
- 4.** Cila është fatkeqësia më e rëndë për këta njerëz? **1 pikë**  
A) Izolimi dhe moskomunikimi.  
B) Ortekët që bien pa pushim.  
C) Vdekjet e papritura.  
D) Pamundësia për të ripërtërirë jetën.
- 5.** Jera acarohet me njerëzit, sepse: **1 pikë**  
A) ata janë fajtorë për humbjen e Dakut.  
B) ata nuk i treguan të vërtetën.  
C) ata nuk e kuptuan.  
D) ata e quajnë fajtorë për vdekjen e Dakut.
- 6.** Çfarë e bën tragjik fatin e Jerës? Gjej në fragmentin e dhënë detaje me të cilat shfaqet tragjikja në fatin e vajzës dhe të njerëzve që jetojnë në ato vise (të paktën 2). **3 pikë**

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

---

7. A mendon se stoicizmi dhe kryeneçësia e Jerës janë brenda psikologjisë së mjedisit? Argumentoje mendimin me ilustrime nga fragmenti. **3 pikë**
8. Pse themi që paralelizmi figurativ ndërmjet natyrës që lulëzohet çdo mars buzë lumit dhe instinkteve njerëzore të Jerës, e portretizon atë së brendshmi? **1 pikë**
9. Gjej paragrafin ku Jera rizbulon e habitur dhe paksa ironike ligjin e ripërtëritjes së natyrës. Kujt i drejtohet ironia (vetes, natyrës apo njerëzve) dhe pse? Ç'figura të tjera stilistike gjen në këtë paragraf (të paktën dy figura bashkë me ilustrimet përkatëse)? **4 pikë**
10. Interpretu nëntekstin që mbartin fjalët e fundit të tregimit. Ndal te detajet që vizatojnë sytë që nuk mbylleshin edhe kur flinte. (Ç'është "diçkaja" që ajo priste?) **2 pikë**
11. Gjej dy fjalë të prejardhura, tipike dialektore, që i japin një bukuri të veçantë gjuhës së Camajt. **2 pikë**  
a. \_\_\_\_\_ b. \_\_\_\_\_
12. Argumento në formë eseje njërin nga variantet e mëposhtme: **10 pikë**  
**A ose B**
- A.** Jeta, vetmia dhe vdekja. Si ndikojnë këto të tria në jetën e personazheve të kësaj novele? Çfarë ka dashur të thotë Camaj në lidhje me natyrën e qenies njerëzore?  
Ose
- B.** *Vetëm dashuria mund të shkrijë akujt e shpirtit.* Nisur nga konteksti i novelës argumento vlerën e këtij pohimi.

**PJESA II**

**ESKILI – “Koeforet” (fragment)**

**Prologu**

*Në sfond të skenës duket pallati i Atridëve me tri portat. Në skenë, varri i Agamemnonit. Hyjnë Oresti e Piladi)*

**ORESTI**

Hermes, o zot i nëndheshëm, që  
vëzhgon

Tim atë atje në ferr, më jep ti  
ndihmë

Dhe aleat m’u bëj. Unë ja, u  
ktheva,

Mërgimin prapa lashë, përmbi  
varr

Të atit tim po rri duke iu lutur

Që poshtë të vërë veshin, të më  
ndjejë.

*(Pret një tufë flokësh dhe e vë mbi  
varr)*

Një tufë flokësh preva për Inakun

Që më ushqen rininë, tufën tjetër

Në shenjë zie ty ta vë, o at:

Un’ s’isha që të qaja vdekjen  
tënde,

Dhe as me dorë s’ta preka dot  
tabutin

Në kohën kur të nxorën nga  
shtëpia.

Po ç’po më shohin sytë? Ç’është  
ky vargan

Prej grash që pikëllueshëm po  
afrohen

Përzishëm veshur? Ç’zi e re ka  
ndodhur?

Pallatin ç’gjëmë prapë ka goditur?

Apo mos vallë blatime ato i sjellin  
Tim et të vdekur për ta  
ngushëlluar?

Ah, po, më duket se po shoh  
Elektrën,

Elektrën, midis tyre, time motër

Me vulën e trishtimit në fytyrë.

O Zeus, më ndihmo që t’i marr  
gjakun

Babait të vrarë. Eja pra, Pilad,

Të fshihemi mënjane për të  
kuptuar

Se ç’duan sot këtu gratë e  
përzishme.

*(Fshihen mënjane. Kori dhe  
Elektra i afrohen varrit)*

**KORI**

**Strofa 1**

**26** Na urdhëruan që mbi varr

Të sjellim sot blatime që me natë

Me grushte gjoksit duke i rënë.

Shikoni faqet si i kam,

Me gjurma gjaku e çjerrë thonjsh!

Nga vaji zemra si s’na plas,

*Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I*

Dhe rrobat qajnë përmbi trup!  
Të linjtat tona përmbi gjoks  
Duke i shqyer ditë e natë

**35** I bëmë copë.

**Antistrofa 1**

Me një mënyrë të qartë fort,  
Që leshrat nga llahtari ngre  
përpyjetë  
Ah, profecia e shtëpisë  
Me gjuhë ëndrrash foli mbrëmë  
Hakmarrje frikshme duke ndjellë.  
Në mes të natës, në pallat  
Një britmë e tmerrshme mbushi  
dhomat  
E grave, thonë që mbretëreshës  
Ëndërrshpjeguesit i thanë se kjo  
tregon që nga skëtterra

të vrarët turren t'egërsuar  
për kundër vrasësve.

**Strofa 2**

Dhe me qëllim që të largojë  
Prej vetes kobin, ah, moj tokë  
Kjo grua e mbrapshtë, që më  
ngjeth  
Vetëm me emrin, më dërgoi  
Të sjell blatime përmbi varr.  
Po frikë kam në zemrën time  
Të tilla fjalë të lëshoj.  
Dhe vallë a mund të lahet dot  
Gjaku i derdhur sipër dheut?  
O vatër gjëmash, o pallat,  
Qysh se i zoti yt u vra  
Një hije e zezë të ra sakaq  
S'të ndahet nata.

*Për pyetjet 13-17 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

**13.** Nga e mori Eskili subjektin për tragjedinë?

**1 pikë**

- A) Baladat e vjetra greke.
- B) Eposi Homerik.
- C) Kronikat historike.
- D) Miti i Atridëve.

**14.** Tragjedia ka në qendër të veprës heronj:

**1 pikë**

- A) mitikë.
- B) realë.
- C) të jashtëzakonshëm.
- D) idealë.

**15.** Si shfaqet Orestin në këtë fragment?

**1 pikë**

- A) Energjik.
- B) I dëshpëruar.
- C) I trembur.
- D) I qetë.

*Matura Shtetërore 2007, Teste*

---

- 16.** Oresti është kthyer nga mërgimi, sepse: **1 pikë**  
A) do të marrë motrën me vete.  
B) do të marrë gjakun e babait.  
C) do të ndajë Klitemnestrën nga Egisti.  
D) do të vizitojë varrin e të atit.
- 17.** Në këtë tragjedi konflikti tragjik zhvillohet: **1 pikë**  
A) brenda familjes mbretërore.  
B) midis familjes mbretërore dhe qytetarëve.  
C) midis familjes mbretërore dhe perëndive.  
D) midis dy mbretërive fqinje.
- 18.** Cili mund të jetë sipas jush kuptimi i vendosjes së një tufe flokësh nga Oresti mbi varrin e të atit? **1 pikë**
- 19.** Cila është atmosfera që krijon mjedisi dhe koha kur zhvillohet kjo skenë? Gjej detajet që japin thelbin e kësaj atmosfere. **2 pikë**
- 20.** Cili është roli i korit në këtë fragment? A është ai më shumë në pozicionin e një aktori apo vëzhguesi? Argumento mendimin tënd. **2 pikë**
- 21.** Cila është e veçanta e ndërtimit sintaksor të vargjeve: “*Prej grash që pikëllueshëm po afrohen/ përzishëm veshur*”? Shpjego forcën e shprehësisë që merr kjo mënyrë ndërtimi. **2 pikë**
- 22.** Në këtë fragment indirekt ndihet prania e Klitemnestrës dhe bota e saj e alarmuar. Çfarë e ka shkaktuar këtë shqetësim? Gjej në fjalët e korit rrjedhojat e këtij shqetësimi. **2 pikë**
- 23.** Në vargjet 26-35 gjej tri detajet dhe interpreto përmes tyre afrinë midis mënyrës greke të të vajtuarit dhe asaj shqiptare. **4 pikë**
- 24.** Kjo tragjedi është përkthyer nga Ismail Kadare. Gjej nga fragmenti një neologjizëm tipik të tij dhe shpjego mënyrën e formimit. **2 pikë**